REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 03-104-02-8512-25
Nr. i fq. / Br. str. / No. pg. 01. 04. 2025
Data / Datum / Date

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
**KOMUNA E OBILIQIT**
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

---

**DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME**

# NJOFTIM

Komuna Obiliqit shpall muajin PRILL/2025, muajin e regjistrimit të lirë civil të personave të paregjistruar në Regjistrin e Lindjeve nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Komuna e Obiliqit, njofton komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, se muaji Prill është muaj i regjistrimit FALAS për të gjithë ata që nuk kanë bërë ende regjistrimin e anëtarëve të familjes.

Inkurajohen këto komunitete që ta kryejnë këtë obligim ligjor FALAS gjatë muajit prill pasi që kanë lehtësira për regjistrim të ri.

Regjistrimi falas ka për qëllim promovimin e të drejtave themelore të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, e sidomos të drejtës së regjistrimit, si segmenti më i rëndësishëm për gjithë përfshirjen e tyre në shoqërinë kosovare.

Në kuadër të kësaj fushate, Komuna ka krijuar lehtësira dhe ofrohen informacione të plota dhe të nevojshme për regjistrimin e mëvonshëm të komuniteteve të cekura më lart.

Për çdo lloj paqartësie dhe dhënie informacioni si dhe lehtësimin e regjistrimit, kontaktoni stafin e Zyrës për të Drejtat e Njeriut.

Drejtore e DAP-it

Linda Bekteshi